



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 395/1 prot.

Tiranë, më 07. 03. 2022

V E N D I M

Nr. 46 , datë 07. 03 . 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, është paraqitur ankesa nr. 47 Regj., datë 02.03.2022, e shtetasit P. D, kundër Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, me pretendim diskriminimin në formën e shoqërimit, për shkak të “gjendjes shëndetësore” të fëmijës së tij² dhe për “çdo shkak tjetër”³.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, subjekti ankues është prind i katër fëmijëve, fëmija i vogël i të cilit vuan nga sëmundje të rënda dhe është diagnostikuar me “Epilepsi të gjeneralizuar. Sindrom hipotonik. Bronkopneumoni bilaterale” dhe aktualisht mbahet me aparat oksigjeni në kushtet e shtëpisë. Ankuesi shprehet se: “Jam i papunë për shkak se djali do përkujdesje të vazhdueshme. Për shkak të një minikredie që nuk

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

² Vërtetuar me dokument mjekësor.

³ Ankuesi ka shënuar “çdo shkak tjetër” tek lista me shkaqet e pretenduara të diskriminimit, në formularin e ankesës pranë KMD-së, pa dhënë shpjegime, prova e fakte se çfarë karakteristike identifikuese, personale posedon ai, e cila të ketë shërbyer edhe si shkak për trajtimin e tij të pabarabartë e të pafavorshëm nga ana e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

kam paguar për arsye se nuk kam të ardhura nga punësimi, pasi jam i papunë, pikërisht për shkak të gjendjes shëndetësore të fëmijës tim i cili ka nevojë për përkujdesjen time të vazhdueshme, më kanë bllokuar të gjitha llogaritë bankare në emrin tim. Çështjen e gjendjes shëndetësore të djalit tim e kam pasqyruar në media të ndryshme televizive si: TV Klan, ABC News, News 24, FAX News dhe kërkesat e mija për ndihmë mund t'i gjeni në kanalën YouTube. Në llogarinë e bllokuar nuk mund të tërheq asnjë donacion të bërë për këtë qëllim.

Të ardhurat e vetme që kam janë nga Kempin i djalit, në shumën prej 9.412 lekësh, por që nuk e tërheq dot nga llogaria bankare për shkak të bllokimit që ka bërë Zyra e Përmbanuesve Gjyqësorë Privatë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shprehimisht: “*Të vlerësohet nëse ka diskriminim dhe të më zhblokohen llogaritë bankare të paktën për Kempin dhe në masën e minimumit jetik”.*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Subjekti ankues, ka ngritur pretendime ndaj Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, lidhur me Urdhrin me nr. 8249 prot., datë 24.12.2021 *“Për vënien e sekuestros konservative”*, drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë. Nga përmbajtja e këtij akti evidentohet se, përmbauesi gjyqësor L. C, me kërkesë të palës kreditore ka regjistruar çështjen përmbarimore me palë:

Kredithënës: MICRO CREDIT ALBANIA SH.A

Kreditor: Micro Credit Albania sh.p.k

Debitor: P. D

Me objekt: Kthim shume, për vënie në ekzekutim të titullit ekzekutiv *“Kontratë Kredie Konsumatore me nr. 1043 Ref.”*, së bashku me *“Urdhrin e Ekzekutimit me nr. 4064 Akti, datë 18.05.2017”*, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nëpërmjet Urdhrit me nr. 8249 prot., datë 24.12.2021 *“Për vënien e sekuestros konservative”*, drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë, Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësore Privatë, ka urdhëruar si më poshtë vijon:

“Vendosjen e sekuestros mbi llogaritë, depozitat apo kreditë e debitorit P. D, në shumën prej 408.220 lekësh deri në shlyerjen përfundimtare të detyrimit.

Detyrimi i mësipërm përbën vlerën monetare totale të detyrimit të palës kreditore i cili përlllogaritet dhe rritet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për kamatën ligjore sipas Normës së Interesit të Bankës së Shqipërisë.

Shumat e mbledhura nga Sekuestro të mbahen të bllokuara në llogaritë bankare të debitorit deri në një urdhër tjetër nga përmbauesi gjyqësor.

Të njoftohemi dhe informohemi menjëherë në lidhje me procedurën e vënies së sekuestros nga ana e juaj, sipas kërkesave të nenit 5, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.03.2014, të Bankës së Shqipërisë.

Lidhur me sa më sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, Ju vë në dijeni se:

Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i procedurës Administrative dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është veprim procedural përmbartimor, i referuar në K.Pr.Civile, palët mund të paraqesin ankim të veçantë sipas K. Pr. Civile para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Ligji nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”, i ndryshuar, në nenin 2⁴, të tij, ka përcaktuar se:

“1. Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

2. Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbartuesve gjyqësorë”.

Pika 1, e nenit 5⁵, të këtij Ligji përcakton se:

“Përmbartuesi gjyqësor është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile”.

Neni 35⁶, pika 1, shkronja dh) e ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”, të ndryshuar, ngarkon me përgjegjësi, me shkarkim nga detyra, përmbartuesin gjyqësor, duke përcaktuar se:

“1.Përmbartuesi gjyqësor shkarkohet nga detyra në këto raste:

a) kur dënohet për kryerjen e një vepre penale;

b) kur kryen shkelje të rënda të disiplinës në punë;

c) kur kryen në mënyrë të përsëritur thyerje të disiplinës dhe nuk i është hequr masa e dhënë më parë;

ç) kur provohet se ka përdorur funksionin e tij në shërbim të interesave vetjake ose të personave me të cilët ka lidhje familjare;

d) kur provohet se me veprimet ose mosveprimet e tij ka krijuar favore të padrejta për persona të tjerë;

dh) kur nuk përmbush veprimet përmbartimore të parashikuara në ligj;

e) kur është vlerësuar “i paaftë” në përputhje me pikën 2 të nenit 14 të këtij ligji”.

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim, K.Pr.C), në nenin 510 të tij ka përcaktuar se, ekzekutimi i detyrueshëm

⁴ Objekti i veprimtarisë

⁵ Përmbartuesi gjyqësor

⁶ Shkarkimi

mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv, dhe se, janë tituj ekzekutivë, sipas përcaktimeve të këtij neni:

- a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;*
- b) vendimet penale të formës së prerë në pjesën që bëjnë fjalë për të drejta pasurore;*
- c) vendimet e gjykatave e të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi;*
- ç) vendimet e një gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë;*
- d) aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare;*
- dh) kambialet, çeqet e letrat me urdhër që barazohen me ato;*
- e) aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përbarimit për ekzekutimin e tyre”.*

Në nenin 515 dhe 524, të tij, K.Pr.C, ka përcaktuar se:

“ Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përbaruesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit. Kur kërkohet ekzekutimi i një detyrimi në të holla, përbaruesi gjyqësor, me kalimin e afatit të lajmërimit për ekzekutim (neni 517), fillon ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit”.

Bazuar në sa më lart, Komisioneri vëren se, Shërbimi i Përbarimit Gjyqësor, ushtron veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përbarimit Gjyqësor”*, të ndryshuar, dhe ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe se, personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile është pikërisht përbaruesi gjyqësor.

Pra, në këtë kontekst, në rastin në fjalë, Komisioneri vlerëson se, përsa kohë përbaruesi gjyqësor *(si pjesë e Dhomës Kombëtare të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë)*, ka zbatuar Urdhrin e Ekzekutimit me nr. 4064 Akti, datë 18.05.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ai ka përmbushur detyrimin e tij në zbatim të detyrave funksionale, konform përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përbarimit Gjyqësor”*, të ndryshuar.

Komisioneri, vëren se, kërkesa e subjekti ankues, për zbllokimin e llogarive bankare të tij, lidhet drejtëpërdrejtë me urdhërimin e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësore Privatë, e cila nëpërmjet Urdhrit me nr. 8249 prot., datë 24.12.2021 “Për vënien e sekuestros konservative”, ka urdhëruar, ndër të tjera edhe vendosjen e sekuestros mbi llogaritë, depozitat apo kreditë e debitorit P. D, në shumën prej 408.220 lekësh deri në shlyerjen përfundimtare të detyrimit.

Ky pretendim i ankuesit mund të zgjidhet vetëm nëpërmjet kontrollit gjyqësor, ankimimit përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, sipas parashikimeve ligjore të K.Pr.C (*E drejtë e cila i është bërë e ditur ankuesit edhe në dispozitivin e Urdhrit nr. 8249 prot., datë 24.12.2021 “Për vënien e sekuestros konservative”, të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë*).

Neni 610⁷ i K.Pr.C, ka parashikuar shprehimisht, se, kundër veprimeve të përmbauesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ky Kod dhe kundër refuzimit të përmbauesit gjyqësor për të kryer një veprim që ia ngarkon ligji, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin.

Për rrjedhojë, trajtimi i kësaj kërkesë të ankuesit, nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) përbën abuzim me të drejtën e ankimimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

- *Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim “për çdo shkak tjetër”.*

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh⁸. Neni 1, i ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh⁹.

Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e

⁷ *Kundërshtimi i veprimeve të përmbauesit gjyqësor.*

⁸ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.*”

⁹ Neni 14, I KEDNJ-së: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.*”

normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Referuar përmbajtjes së nenit 1 të LMD-së, rezulton tepër e qartë dhe evidente, që të gjitha shkaqet e përmendura, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësi, apo karakteristika individuale të personave që pretendojnë për diskriminim. Situata diskriminuese në vetvehte është gjithmonë e lidhur me një veçori individuale të viktimës dhe në rastin konkret, subjekti ankues nuk ka identifikuar një shkak të vlefshëm diskriminimi, që të ketë lidhje me një nga karakteristikat personale të përcaktuara në LMD.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument, indicie apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë shkakut specifik, duke mos arritur të identifikoj se cili është ky shkak.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e ankuesit për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet përbën abuzim me të drejtën e ankimit para Komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon subjektit ankues, që, për problematikën e tij, t’i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike¹⁰, ose Shërbimit Ligjor Falas¹¹.

¹⁰ Me adresë: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, Blv. “Zogu i Parë”, Tiranë.

¹¹ Me adresë: Bulevardi: “Bajram Curri”, Pall: “Agimi”, Shk. 18, Ap. 322, Tiranë, Nr.tel: 0422 53113.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues P. D, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Gjendja shëndetësore, çdo shkak tjetër
Lloji i Vendimit: Mospranim